

Përgatitur nga :xxxxxxxxxx (Universiteti i Tiranës, Shqipëri)

Rasti studimor

Rast mbi akreditimin e programeve të studimeve jo-universitare, profesionale, pas arsimit të mesëm, në “Eficensë energjitike” të ofruara nga Universiteti POLIS.

Fusha dhe niveli i studimit

Shkenca Inxhinierie - Cikli i shkurtër i arsimit të lartë të (brenda ciklit të parë) është një program studimi profesional – 2 vjeçar, që mbulon 120 ECTS e para, të ciklit të parë. Në fund të tij lëshohet Diplomë Profesionale në Eficensë Energjitike.

Informacion i përgjithshëm

Institucionet e arsimit të lartë në vend kanë të drejtë të ofrojnë edhe programe të studimeve jo-universitare, profesionale, pas arsimit të mesëm, me jo më pak se 120 kredite. Ky cikël studimesh- vetëm më një përjashtim, është ofruar nga sektori i arsimit të lartë në vend. Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisu” ka ndërmarrë rolin kryesor në promovimin e këtyre programeve të Shqipëri. Universitetet të tjera të përfshira në arsimin e formimin profesional janë Universiteti Bujqësor i Tiranës me filialin e tij në Lushnjë, Universiteti i Elbasanit, Universiteti privat POLIS dhe shkolla e lartë universitare private “New Generation”.

Përshkrimi i rastit

Programi i Studimit Profesional Jo-universitar në Eficiency Energjitike është hapur me urdhër nr. 315, datë 21.7.2014 për ‘Hapjen e programit të ciklit të parë “Bachelor” pranë Fakultetit “Arkitekturë dhe Dizajn” dhe programit të studimit jo-universitar pranë Fakultetit “Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban” në Universitetin “POLIS”. Ky është një program profesional jo-universitar, me kohëzgjatje dy vjet me kohë të pjesshme, me 120 ECTS në përfundim të të cilit lëshohet diploma me emërtimin: “Diplomë Profesionale në Eficiency Energjitike”. Programi Profesional Jo-universitar në Eficiency Energjitike është hartuar dhe zhvillohet në kuadër të projektit Tempus DAPEEËB (“Developing and Adapting Professional Programs for Energy Efficiency in the Western Balkans”, Project Nr. 543782-TEMPUS-1-2013-1-AL-TEMPUS-JPCR), projekt i cili ka një shtrirje kohore prej Dhjetor 2013 deri në Nëntor 2016.

Pranimet e para në këtë program studimi janë bërë në vitin akademik 2013-2014 ku janë pranuar 14 studentë, ndërsa vitin aktual 2014-2015, 25 studentë. Sipas parashikimeve ligjore në fuqi, ky program duhet të akreditohet përpara lëshimit të diplomave të para. Universiteti POLIS me urdhër të rektorit ngriti grupin e brendshëm të vlerësimit për hartimin e raportit të brendshëm të cilësisë. Hartimi i raportit të vlerësimit të brendshëm do të bëhet sipas standarteve shtetërore të Cilësisë për akreditimin e programeve të studimit, të miratuara me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 75 datë 19.02.2013 “Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve”. Gjatë punës, për hartimin e këtij raporti, dhe nga trajnimet e realizuara me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë, GVB u udhëzua të hartonte këtë

raport sipas standardeve shtetërore të cilësisë, për ciklin e parë të studimeve “Bachelor”. Ashtu sic evidentoi dhe GVB **akoma nuk janë detajuar** standardet e cilësisë për Diplomën Profesionale 2-vjeçare (fq 2 e raportit të GBV). Ky raport u hartua sipas standardeve shtetërore të cilësisë për programet e ciklit të parë “Bachelor”, duke përdorur indikatorët e suksesit në përmbushje e standardeve për ciklin e parë të studimeve. Edhe grupi i jashtëm i vlerësimit në vlerësimin e tij përdori indikatorë të njëjtë vlerësimi për ciklin e parë “Bachelor” (http://www.aaal.edu.al/dokumente/IAL_private/Polis/Raporti%20i%20Vleresimit%20te%20Jashtem%20Diplome%20Prof.%20Eficence%20Energjitike.pdf) . Programi i studimit u akreditua me urdhër nr. 315 datë 17.06.2015 të ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Kuadri Ligjor

Neni 26 i ligjit nr. 9741 datë 21.05.20017 “Për arsimin e lartë në RSh” i ndryshuar:

“ Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të ofrojnë edhe programe të studimeve jo-universitare, profesionale, pas arsimit të mesëm, me jo më pak se 120 kredite. Kohëzgjatja normale e këtyre programeve është jo më pak se 2 vite akademike dhe në përfundim të tyre lëshohet “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer. Kreditet e akumuluar gjatë studimeve pas arsimit të mesëm mund të transferohen në studimet universitare të ciklit të parë, në përputhje me kriteret që vendosin institucionet e arsimit të lartë

Neni 63 pika 3 e LAL nr. 9741 datë 21.05.2007 :

“cdo institucion i arsimit të lartë apo program studimi në arsimin e lartë publik dhe privat, përpara lëshimit të diplomave të para, i nënshtrohet procesit të akreditimit të parë. Akreditimi i parë i jep të drejtën institucionit publik ose privat të arsimit të lartë të lëshojë diploma të njohura në RSH. “

Neni 61 pika 2 i ligjit të sipërcituar :

“Vlerësimi dhe akreditimi mbështeten në standardet shtetërore të Cilësisë. Këto standarde përcaktohen në akte nënligjore të Ministrisë s Arsimit dhe Shkencës.”.

Urdhër nr 75 19.02.2013 Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit.